VENDIM
Nr. 505, datë 30.5.2013

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS "BOT", TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE "FINSEC" LTD DHE "DOPRASTAV" SA, PËR NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PORTIT TË JAHTEVE NË KOMUNËN SYNEJ, KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit si autoritet kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Finsec" ltd. dhe "Doprastav" SA si koncesionarë për ndërtimin e portit të jahteve në komunën Synej, Kavajë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha